



РЕПУБЛИКА СЕВЕРНА МАКЕДОНИЈА
REPUBLIKA E MAQEDONISË SË VERIUT



Бр./Nr _____

_____ р./в.



Në bazë të nenit 22 paragrafi 1 nga Ligji për parandalimin e korrupsionit dhe konfliktit të interesave ("Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë " Nr. 12/2019) neni 40 paragrafi 3 nga Rregullorja për punë të Komisionit Shtetërorë për Parandalimin e Korrupsionit, duke vepruar sipas denoncimit të parashtruar nga parashtrues i panjohur KSHPK (në tekstin e mëtejshëm) në seancën e 54-të, të mbajtur më 02.11.2021, morri vendimin vijues:

VENDIM

Procedura sipas lëndës me nr. Nr. 09-2460 / 1 të datës 08.07.2021, i formuar pas denoncimit të dorëzuar për personat zyrtar/// dhe ///, anëtarë të këshillit të ///, NDËRPRITET

Pas ndërmarrjes së disa aktiviteteve nga ana e KSHPK-së, ka pasur ndryshim të gjendjes faktike të personave të denoncuar dhe KSHPK-ja nuk ka elemente për veprime të mëtutjeshme.

Vendimi në formë të depersonalizuar, të publikohet në ueb - faqen e KSHPK-së brenda 5 (pesë) ditëve nga dita e vendimmarrjes.

Arsyetim

Me datë 08.07.2021, nga parashtrues i panjohur është dorëzuar denoncim për/// dhe /// për akumulim të funksioneve, sepse përveç anëtarëve të Këshillit ///, janë edhe anëtarë të Bordit të Shkollës në/// . Këto funksione janë të papajtueshme dhe në kundërshtim me dispozitat e Ligjit për Parandalimin e Korrupsionit dhe Konfliktit të Interesit, me të cilin është themeluar lënda me numër 09-2460/1 datë 08.07.2021.

Në denoncim parashtruesi thekson se me datë 15.06.2021 është mbajtur intervistë për zgjedhjen e drejtorit pas shpalljes publike për zgjedhjen e drejtorit të shkollës fillore /// në të kanë marrë pjesë /// dhe /// si anëtarët e ///, dhe përzgjedhja bëhet në gjendje të grumbullimit të funksioneve.

Për verifikimin e pretendimeve të paraqitura në denoncim, dhe për konstatimin e gjendjes faktike, KSHPK-ja i është drejtuar shkollës fillore /// dhe ka dorëzuar kërkesë për dorëzim të të dhënave dhe informatave lidhur me procedurën për përzgjedhjen e drejtorit të shkollës, si dhe të gjitha procesverbalet nga mbledhjet e bordit të shkollës. Në të njëjtën kohë, ai ka paraqitur kërkesë në Komunën /// për marrjen e vendimeve për emërimin e personave të përmendur për anëtarë të këshillit të shkollës.

Nga dokumentacioni i siguruar shihet se pohimet në denoncim janë vërtetuar, përkatësisht në këshillin e shkollës janë edhe këshilltaret /// dhe ///.

Në bazë të gjendjes faktike të vërtetuar, KSHPK-ja në seancën e 50-të ka marrë vendim me të cilin është konstatuar gjendje e konfliktit të interesit ndërmjet personave /// dhe ///, sepse kanë vepruar në kundërshtim me nenin 44 paragrafi 4 të KSHPK-së.

Në bazë të nenit 77 paragrafit 1 të KSHPK-së, KSHPK-ja ua dorëzoi vendimin personave zyrtarë dhe kërkoi nga ata që në afat prej 15 ditësh të ndërmarrin veprime për eliminimin e situatës së konfliktit të interesit. Pas kësaj situatë, personat zyrtarë /// dhe /// e njoftuan KSHPK-në se kanë vepruar sipas udhëzimit, gjegjësisht kanë dhënë dorëheqje nga pozita e anëtarit të Bordit të shkollës, për çka kanë paraqitur akt-kërkesë për ndërprerje të funksionit të anëtarit të ///.

Duke pasur parasysh sa më sipër, KSHPK-ja ka konstatuar se situata ka ndryshuar dhe ka vendosur të ndërpresë procedurën në këtë rast për shkak se është arritur efekti, përkatësisht është tejkaluar shkelja e dispozitave ligjore që ndalojnë kryerjen e dy funksioneve.

Duke pasur parasysh të theksuarën e mësipërme, Komisioni Shtetëror për Parandalimin e Korrupsionit vendosi si në dispozitën e këtij vendimi.

Dorëzuar deri te:
Parashtruesi i denoncimit

Përgatiti: E.N, bashkëpunëtor
Miratoi: NB, anëtar i KSHPK - së

KOMISIONI SHTETËROR
PËR PARANDALIMIN E KORRUPTIONIT
KRYETAR,
Biljana Ivanovska